



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 222

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË  
ZGJEDHJEVE, PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS  
14 MAJ 2023**

Sot, më datë 30.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve me seli në Tiranë,  
Rr. Abdyl Frashëri, Pallati 3/3, Tiranë

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi për vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet  
e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi  
Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë  
27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit  
dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe  
të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe  
mediave”

Data: 30.3.2023 Nr: 222  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e  
Sistemit të Zgjedhjeve, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e  
qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”

## V Ë R E J:

Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për 30 (tridhjetë) vëzhgues afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 19, datë 27.1.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave ”,

## V E N D O S :

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 30 (tridhjetë) vëzhguesve afatgjatë të Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**